



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 73 Prot

Tiranë, më 04,05, 2011

VENDIM Nr. 158, dt. 04.05.2011

(Vendim Qarkullues)

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë mbasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik të Projektit të Rikonstruksionit të Rrugës Lezhë Kala – Lagjja Shehër", financuar nga "Fondi Shqiptar i Zhvillimit",

VENDOSI:

I. Të miratojë projektin e "Rikonstruksionit të rrugës Lezhë Kala – Lagjja Shehër" financuar nga "Fondi Shqiptar i Zhvillimit", bazuar në raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik të kryer nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

II. Specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me specialistë të Zyrës së Menaxhimit të Parkut Arkeologjik, Lezhë të kryejnë mbikëqyrjen arkeologjike deri në përfundimin e procesit të zbatimit të punimeve sipas projektit të paraqitur nga FSHZH.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

SUZANA TURKU

ZY. MINISTRE

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK